REZOLUTË

PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË AUTORITETIT TË MBIKËQYRJES FINANCIARE PËR VITIN 2025 DHE REKOMANDIMET PËR VITIN 2026

Kuvendi i Shqipërisë,

Duke vlerësuar kontributin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në drejtim të nxitjes së qëndrueshmërisë, transparencës dhe besueshmërisë së tregjeve nën mbikëqyrje;

Duke njohur misionin e Autoritetit për krijimin e një tregu bashkëkohor dhe efektiv, që ofron shërbime cilësore dhe promovon zhvillimin e mëtejshëm të sektorit financiar jobankar në vend;

Duke mbështetur e zhvilluar bashkëpunimin me këtë Autoritet, si dhe duke nxitur bashkëpunimin e tij me institucionet kombëtare e ndërkombëtare;

Vlerëson veprimtarinë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare gjatë vitit 2025, në drejtim të:

Zhvillimit të një qasjeje të avancuar mbikëqyrëse, të bazuar në analizën e treguesve financiarë dhe prudencialë, me fokus në vlerësimin e profilit të rrezikut të subjekteve, identifikimin në kohë të ekspozimeve dhe ndërhyrjen proporcionale në funksion të ruajtjes së stabilitetit të tregjeve nën mbikëqyrje, rritjes së transparencës dhe mbrojtjes së interesave të konsumatorëve dhe investitorëve.

Konsolidimit të rolit institucional si strukturë drejtuese për kapitullin 9 "Shërbimet financiare" në një fazë më të avancuar të procesit të integrimit evropian, ku veprimtaria ka tejkaluar përmbushjen formale të detyrimeve raportuese dhe është orientuar drejt thellimit të reformave ligjore dhe rregullatore në të gjitha tregjet nën mbikëqyrje, duke reflektuar një qasje më të strukturuar dhe progresive në përafrimin e kuadrit kombëtar me *acquis-n* e Bashkimit Evropian.

Avancimit të mëtejshëm të reformës në sektorin e sigurimeve përmes zbatimit të udhërrëfyesit 7-vjeçar për kalimin drejt regjimit *Solvency II*, ku gjatë vitit 2025 u përmbyll faza e parë e ushtrimit të Vlerësimit të Ndikimit Sasior me përfshirjen e të gjitha shoqërive të sigurimit dhe me mbështetjen teknike të Bankës Botërore, duke shënuar një hap konkret drejt kalimit nga një mbikëqyrje e bazuar në rregulla drejt një modeli prudencial të orientuar nga rreziku dhe drejt forcimit të qëndrueshmërisë financiare të tregut.

Përgatitjes së tregut të sigurimeve për zbatimin e standardit SNRF 17 përmes ndërmarrjes së hapave konkretë rregullatorë dhe mbikëqyrës, duke përfshirë miratimin dhe zbatimin e kërkesave për raportim gjatë periudhës tranzitore, zhvillimin e trajnimeve të dedikuara në bashkëpunim me Bankën Botërore, si dhe ngritjen e grupeve të punës për hartimin e një plani të plotë raportimi financiar dhe për rishikimin e kuadrit ekzistues nënligjor.

Përfundimit të procesit të përshtatjes së subjekteve të tregut të pensioneve private me kërkesat e ligjit nr. 76/2023, "Për fondet e pensionit privat" dhe akteve nënligjore përkatëse brenda afatit 18-mujor të parashikuar për katër shoqëri administruese, gjashtë fonde pensioni dhe pesë depozitarë, duke përfshirë rishikimin e rregullave operacionale, forcimin e qeverisjes së brendshme, kontrollit dhe administrimit të rrezikut, si dhe përmbushjen e kritereve "*fit and proper*" për personelin kyç, çka përbën një zhvillim me rëndësi për rritjen e besimit, mbrojtjen e anëtarëve dhe zhvillimin e pensioneve private si instrument afatgjat kursimi.

Zhvillimit të kuadrit rregullator në tregun e kapitaleve përmes hartimit të paketës ligjore që përfshin projektligjin për marrjen në kontroll të shoqërive me ofertë publike dhe projektligjin për kërkesat e transparencës për emetuesit e titujve, duke forcuar standardet e raportimit financiar dhe mbrojtjen e investitorëve, si dhe përmes miratimit të rregullores nr. 61/2025, "Për formën dhe procedurën e regjistrimit të aktofertës për emetimin e titujve të borxhit", e cila përbën një ndërhyrje të rëndësishme rregullatore në funksion të standardizimit të procedurave të emetimit, rritjes së transparencës dhe sigurisë juridike për pjesëmarrësit në treg.

Modernizimit të kuadrit mbikëqyrës në drejtim të qëndrueshmërisë operacionale digjitale, në përputhje me standardet e DORA-s, përmes nisjes së procesit për përgatitjen e akteve rregullatore që vendosin kërkesa për menaxhimin e rreziqeve të teknologjisë së informacionit, forcimin e reziliencës ndaj incidenteve kibernetike dhe garantimin e vazhdimësisë së aktivitetit.

Mbikëqyrjes efektive të tregjeve financiare jobankare përmes realizimit të 41 inspektimeve në vend, të ndërthurura me monitorimin e vazhdueshëm *off-site* mbi bazën e treguesve financiarë dhe operativë, duke përfshirë inspektime me bazë rreziku dhe kontrolle tematike në segmente kyçe të tregut, të cilat kanë konkluduar në marrjen e 13 masave administrative dhe korrigjuese, si dhe në një sërë rekomandimesh të adresuara për tregje dhe subjekte specifike.

Zhvillimit të mekanizmave rregullatorë dhe mbikëqyrës në fushën e parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit (AML/CFT) përmes ndërhyrjeve të targetuara në 12 akte nënligjore, të cilat përmirësojnë identifikimin e pronarit përfitues fundor, përforcojnë verifikimin e listave të sanksioneve ndërkombëtare, në kuadër të procesit "*fit and proper*" dhe rrisin standardet e monitorimit të integritetit të aksionarëve dhe drejtuesve, si dhe përmes intensifikimit të kontrollit në terren me realizimin e 10 inspektimeve *on-site* pranë shoqërive komisionere, përfshirë edhe subjekte bankare, një pjesë e të cilave në bashkëpunim me Bankën e Shqipërisë.

Përmirësimit të funksionimit të Fondit të Kompensimit nëpërmjet ushtrimit të mbikëqyrjes dhe kontrolleve mbi zbatimin e kuadrit ligjor, çka ka kontribuar në uljen e dëmeve pezull me 8.67% gjatë vitit, trajtimin e rreth 70% të rasteve me procedura të përshpejtuara dhe realizimin e pagesave në nivelin 98.5% të fondit vjetor, duke reflektuar një funksionim më efikas dhe një ndarje më të qartë të përgjegjësive, në përputhje me ligjin nr. 32/2021, "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", i ndryshuar.

Angazhimit në zhvillimin e financave të gjelbra dhe financimit të qëndrueshëm nëpërmjet përfshirjes në projektin e mbështetur nga Banka Botërore dhe financuar nga SECO, i cili ka përfshirë zhvillimin e komponentëve konkretë, si: rishikimi i kuadrit rregullator për fondet e pensioneve private, avancimi i instrumenteve të tregut të kapitaleve, përfshirë obligacionet e gjelbra, si dhe përmirësimi i sistemeve të raportimit, në koordinim me Ministrinë e Financave dhe Bankën e Shqipërisë, duke krijuar baza më të qarta për orientimin e tregjeve jobankare drejt financimit të qëndrueshëm.

Zhvillimit të një qasjeje më të avancuar në mbrojtjen e konsumatorit dhe investitorit, duke e orientuar mbikëqyrjen përtej trajtimit individual të ankesave drejt analizës së sjelljes së tregut përmes raporteve tematike dhe analizës 12-mujore të ankesave.

Forcimit të edukimit financiar përmes organizimit të aktiviteteve informuese dhe trajnimeve të dedikuara, si dhe bashkëpunimeve me partnerë institucionalë dhe programeve edukative që synojnë rritjen e njohurive për tregjet financiare, përfshirë fondet e pensioneve private.

Vijimit të bashkëpunimit me Byronë Shqiptare të Sigurimit për zbatimin e rekomandimit të Komitetit të Përbashkët të Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë të Evropës Qendrore (CEFTA) për lehtësimin e lëvizjes ndërkufitare të automjeteve, duke finalizuar procesin e lëshimit të policave "Karton Jeshil", 1-vjeçare me prim të reduktuar drejt Malit të Zi dhe Maqedonisë së Veriut dhe duke kontribuar edhe në nxitjen e shkëmbimeve ekonomike mes këtyre vendeve.

Angazhimit në hartimin e kuadrit për zhvillimin e sigurimeve në bujqësi përmes pjesëmarrjes aktive në grupin ndërinstitucional të punës, të ngritur në kuadër të bashkëpunimit me Ministrinë e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrinë e Bujqësisë dhe Pylltarisë të Republikës së Turqisë, si dhe përmes shkëmbimit të praktikave më të mira ndërkombëtare, duke kontribuar në përcaktimin e elementeve rregullatore që lidhen me tarifimin, kufijtë e përgjegjësisë dhe administrimin e rrezikut, me synim krijimin e një skeme funksionale dhe të qëndrueshme për mbulimin e rreziqeve në sektorin bujqësor, e cila pritet të rrisë mbrojtjen financiare të fermerëve, të përmirësojë aksesin në financim dhe të nxisë zhvillimin e produkteve të reja të sigurimit në këtë segment ende të pazhvilluar të tregut.

Kuvendi rekomandon që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2026, të angazhohet në këto drejtime:

1. Të përshpejtojë procesin e hartimit dhe miratimit të paketës së re ligjore në sektorin e sigurimeve, duke siguruar koordinim të plotë ndërmjet ligjit të ri "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", kuadrit për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në sigurime dhe ligjit "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit", në funksion të përafrimit të legjislacionit vendas me Direktivën 2009/138/EC "*Solvency II*", Direktivën (BE) 2016/97 për shpërndarjen e sigurimeve, Direktivën 91/674/EEC për raportimin financiar të shoqërive të sigurimit, Direktivën (BE) 2025/1

për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në sigurime, si dhe Direktivën 2009/103/EC të ndryshuar me Direktivën (BE) 2021/2118, për sigurimin e detyrueshëm motorik, me qëllim krijimin e një kuadri të integruar prudencial dhe mbikëqyrës të harmonizuar me *acquis-n e* Bashkimit Evropian, si dhe përcaktimin e qartë të afateve të zbatimit, masave tranzitore dhe kërkesave të reja prudenciale për tregun.

2. Të vijojë dhe të intensifikojë përgatitjet për zbatimin e udhërrëfyesit për përafrimin me regjimin *Solvency II,* duke konsoliduar kapacitetet teknike, institucionale dhe mbikëqyrëse të Autoritetit dhe të tregut të sigurimeve, përfshirë kryerjen e ushtrimeve teknike, vlerësimeve sasiore, analizave të hendekut dhe përgatitjen e metodologjive e projektakteve të nevojshme, si dhe forcimin e sistemeve të raportimit, menaxhimit të riskut dhe qeverisjes së brendshme të shoqërive të sigurimit. Në kuadër të ushtrimit të funksionit të llogaridhënies ndaj Kuvendit, të raportojë çdo 6 muaj për rezultatet e këtyre ushtrimeve, nivelin e gatishmërisë së tregut, problematikat e evidentuara, masat e ndërmarra për adresimin e tyre, si dhe ndikimin e pritshëm të reformës mbi aftësinë paguese, kërkesat për kapital dhe qëndrueshmërinë financiare të sektorit.

3. Të forcojë kapacitetet institucionale dhe teknike për zbatimin e regjimit të ri prudencial nëpërmjet investimeve në sistemet e raportimit dhe analizës së riskut, trajnimit të specializuar të stafit mbikëqyrës dhe rritjes së bashkëpunimit me institucionet ndërkombëtare dhe autoritetet homologe evropiane, me qëllim garantimin e një tranzicioni efektiv dhe të qëndrueshëm të tregut shqiptar të sigurimeve drejt standardeve të Bashkimit Evropian.

4. Të përgatisë tregun për zbatimin e SNRF 17 përmes kërkesës për plane konkrete implementimi nga shoqëritë e sigurimit, përcaktimit të kalendarëve të raportimit dhe monitorimit periodik të gatishmërisë së tregut, duke adresuar në kohë mangësitë që lidhen me sistemet IT, cilësinë e të dhënave, kapacitetet aktuariale, metodologjitë e vlerësimit dhe standardet e raportimit financiar, me synim rritjen e transparencës, krahasueshmërisë dhe cilësisë së pasqyrave financiare të tregut të sigurimeve.

5. Të nxisë zhvillimin e produkteve vullnetare në segmentet e sigurimit të pasurisë, jetës, shëndetit, bujqësisë dhe mbrojtjes ndaj katastrofave natyrore, duke analizuar praktikat dhe modelet më të mira ndërkombëtare për mbulimin e riskut katastrofik dhe riskut sizmik, si dhe duke përgatitur masa dhe instrumente konkrete për rritjen e penetrimit të këtyre produkteve në treg, forcimin e edukimit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit.

6. Të ndërmarrë masa konkrete për zhvillimin e tregut të kapitaleve dhe diversifikimin e instrumenteve financiare, duke përshpejtuar krijimin dhe funksionalizimin e Skemës së Kompensimit të Investitorëve, në bashkëpunim me Agjencinë e Sigurimit të Depozitave, si një mekanizëm thelbësor për rritjen e mbrojtjes së investitorëve dhe besimit në treg.

7. Të vijojë punën për hartimin e ligjit të ri "Për tregjet e kapitalit" dhe akteve përkatëse nënligjore, në kuadër të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis-n* e Bashkimit Evropian për tregjet e kapitalit dhe infrastrukturat financiare, përfshirë Direktivën MiFID II, kuadrin prudencial IFD/IFR për shoqëritë e investimit, Rregulloren CSDR për depozitarët qendrorë të titujve dhe Rregulloren EMIR për derivativët, kundërpalët qendrore dhe regjistrat e transaksioneve, si dhe të finalizojë kuadrin për obligacionet e mbuluara, me synim zgjerimin e instrumenteve financiare, forcimin e sigurisë dhe eficiencës së infrastrukturave financiare, përmirësimin e mbrojtjes së investitorëve dhe krijimin e alternativave më të zhvilluara të financimit për ekonominë shqiptare.

8. Të avancojë në miratimin e projektligjit "Për sipërmarrjet e investimeve kolektive" dhe projektligjit "Për administruesit e fondeve të investimeve alternative" në funksion të përafrimit të kuadrit ligjor dhe rregullator me *acquis-n e* Bashkimit Evropian për fondet e investimit dhe administrimin e aseteve, si dhe njëkohësisht të forcojë mbikëqyrjen e këtij segmenti përmes rritjes së kapaciteteve për monitorimin e riskut, likuiditetit, transparencës dhe produkteve të reja financiare, me qëllim garantimin e stabilitetit të sektorit dhe rritjen e mbrojtjes së investitorëve.

9. Të avancojë me ndryshimet në ligjin kuadër të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe paraqitjen e tyre në Kuvend, me qëllim përafrimin e kuadrit të funksionimit dhe qeverisjes së Autoritetit me standardet dhe praktikat e autoriteteve homologe mbikëqyrëse financiare, në përputhje me rekomandimet e IAIS dhe audituesit të pavarur, duke përfshirë rishikimin e mënyrës së

përllogaritjes së fondit rezervë, administrimin e suficitit financiar, si dhe politikat e paspunësimit për stafin dhe drejtuesit, në funksion të forcimit të pavarësisë institucionale, integritetit, transparencës dhe shmangies së konfliktit të interesit.

10. Të konsolidojë modelin e mbikëqyrjes me bazë rreziku përmes forcimit të analizës *off-site*, instrumenteve të paralajmërimit të hershëm dhe monitorimit të treguesve prudencialë, si dhe të rrisë mbulimin dhe frekuencën e inspektimeve në vend, veçanërisht në segmentet me mbikëqyrje më të kufizuar gjatë vitit 2025, përfshirë ndërmjetësit në sigurime, fondet alternative të investimit, subjektet e tregut të kapitalit dhe aktivitetet e lidhura me asetet virtuale, duke forcuar njëkohësisht kontrollin në drejtim të mbrojtjes së konsumatorit dhe parandalimit të pastrimit të parave.

11. Të forcojë kontrollin mbikëqyrës mbi Fondin e Kompensimit dhe Byronë Shqiptare të Sigurimit, me synim uljen e mëtejshme të stokut të dëmeve pezull, ndjekjen e detyrimeve të prapambetura dhe interesave të papaguara, rritjen e frekuencës së verifikimeve dhe përmirësimin e trajtimit të kërkesave për dëmshpërblim dhe kohës së pagesës ndaj qytetarëve.

12. Të forcojë transparencën institucionale dhe llogaridhënien publike në procesin vendimmarrës të Bordit, duke publikuar aktet rregullatore të miratuara dhe ndryshimet përkatëse, si dhe vendimet për marrjen e masave administrative dhe korrigjuese, me evidentimin e votimit individual të anëtarëve të Bordit dhe të rasteve të përjashtimit nga vendimmarrja për shkak të konfliktit të interesit, në zbatim të nenit 22, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar. Publikimi të kryhet në përputhje me parimin e proporcionalitetit, duke garantuar mbrojtjen vetëm të atyre elementeve që përbëjnë informacion konfidencial sipas nenit 24, të ligjit nr. 9572, datë 3.7.2006, "Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare", i ndryshuar, nëpërmjet anonimizimit ose redaktimit të pjesshëm, pa cenuar publikimin e vetë aktit, bazës ligjore, arsyetimit dhe elementeve thelbësore të vendimmarrjes.

13. Të forcojë koordinimin ndërinstitucional për stabilitetin financiar dhe parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke rritur shkëmbimin e informacionit me institucionet partnere dhe monitorimin e ekspozimeve të subjekteve të mbikëqyrura ndaj rreziqeve të lidhura me integritetin financiar dhe sanksionet ndërkombëtare.

14. Të përmirësojë kapacitetet institucionale dhe administrative në funksion të procesit të integrimit evropian dhe rritjes së kompleksitetit të mbikëqyrjes, duke plotësuar vakancat ekzistuese, duke përmirësuar politikat e rekrutimit dhe zhvillimit profesional, si dhe duke garantuar që struktura e re organizative të shoqërohet me rritje reale të kapaciteteve teknike dhe jo vetëm me ndryshime formale organizative.

15. Të intensifikojë investimet në digjitalizim, siguri kibernetike dhe qëndrueshmëri operacionale në përputhje me standardet dhe zhvillimet e reja teknologjike, duke garantuar mbrojtjen e infrastrukturës institucionale dhe vazhdimësinë e funksioneve kritike mbikëqyrëse.

16. Të ndërmarrë masa për rritjen e edukimit financiar dhe ndërgjegjësimit publik në tregjet financiare jobankare, me fokus të veçantë në pensionet private, fondet e investimit dhe produktet e sigurimit me komponent investimi, duke kaluar nga aktivitetet sporadike informuese drejt programeve të strukturuara, të matshme dhe të vazhdueshme të edukimit financiar.

17. Të monitorojë strukturën e investimeve të shoqërive të sigurimit, me fokus rreziqet që burojnë nga përqendrimi i lartë në pasuri të paluajtshme, duke nxitur diversifikimin e portofolit drejt instrumenteve të tjera financiare, në përputhje standardet ndërkombëtare dhe zhvillimin e qëndrueshëm të tregut financiar.

18. Deri në fund të vitit 2026 të kryejë një analizë të plotë të zbatimit dhe efektivitetit të Rregullores nr. 156/2024, "Për përcaktimin e faktorëve të riskut që përfshihen në përllogaritjen e primit për produktet e sigurimit të detyrueshëm në sektorin e transportit", duke e krahasuar atë me praktikat më të mira të vendeve të Bashkimit Evropian dhe mbi bazën e rezultateve të analizës, të ndërmarrë ndryshimet e nevojshme rregullatore për zgjerimin e faktorëve të aplikueshëm të riskut, rishikimin e koeficientëve përkatës, në veçanti për faktorin "zona gjeografike", përmes një klasifikimi më të detajuar të territorit sipas karakteristikave dhe nivelit të ekspozimit të secilës zonë, me qëllim përmirësimin e përllogaritjes së primit dhe forcimin e funksionimit të sistemit *bonus–malus.*

19. Të monitorojë në mënyrë periodike, në kuadër të kompetencave të saj mbikëqyrëse, funksionimin e sistemit të shkëmbimit të informacionit në tregun e sigurimit të detyrueshëm TPL/MTPL, duke verifikuar korrektësinë e raportimit në kohë reale të policave dhe primeve të sigurimit, respektimin e kërkesave që lidhen me funksionimin e sistemit, si dhe ndikimin e tij në transparencën e tregut, mbrojtjen e interesave të konsumatorëve dhe funksionimin efektiv të tregut të sigurimeve, duke raportuar çdo 6 muaj për rezultatet e monitorimit dhe problematikat e evidentuara.

20. Të sigurojë zbatimin në kohë të rekomandimeve dhe vendimeve të institucioneve të pavarura, duke raportuar periodikisht çdo 4-muaj në Kuvend për masat e ndërmarra dhe statusin e zbatimit të tyre në përmbushje të detyrimeve institucionale, si dhe standardeve evropiane.

21. Të konsolidojë mekanizmat e transparencës institucionale, duke forcuar funksionin e koordinatorit për të drejtën e informimit dhe duke garantuar publikimin e informacionit sipas standardeve të të dhënave të hapura dhe ripërdorimit të informacionit të sektorit publik.

22. Të bashkëpunojë me strukturat përgjegjëse të Kuvendit të Shqipërisë për zhvillimin dhe konsolidimin e metodologjisë së standardizuar të treguesve kyç të performancës, si bazë për monitorimin dhe vlerësimin e zbatimit të rekomandimeve të rezolutës, në funksion të forcimit të llogaridhënies dhe mbikëqyrjes parlamentare. Ky angazhim të përmbushet brenda 3-mujorit të tretë të vitit 2026.

Miratuar në datën 16.7.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi